

INFORMACION PËR TESTIMIN E PACIENTËVE ME COVID-19

Maj 2020

Shumica e personave me infeksionin COVID-19 kanë një sëmundje të shkurtër me ethe, kollë dhe dhimbje fyti. Disa kanë dhe humbje të ndjesisë së erës dhe/ose të shijes, dhe disa kanë vështirësi në frymëmarrje. Infeksioni mund t'u ngjitet të tjerëve përmes kollitjes ose teshtitjes, si dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë. Është e rëndësishme të mbani një maskë kur largoheni nga shtëpia, për t'ju ndihmuar të mbroni veten dhe për të parandaluar përhapjen e sëmundjes. **Analiza me tampon nga hunda për COVID-19 pikas virusin konkret që shkakton infeksionin e COVID-19.**

Çfarë do të thotë kur rezultati i analizës është pozitiv?

Nëse keni rezultat pozitiv në analizën e tamponit nga hunda, do të thotë që mund të jeni infektuar me virusin e COVID-19.

Çfarë do të thotë kur rezultati i analizës është negativ?

Nëse keni rezultat negativ të analizës me tampon nga hunda, do të thotë se ose nuk jeni infektuar me virusin e COVID-19, ose se jeni infektuar me virusin e COVID-19, por analiza nuk ka arritur ta pikasë virusin. Ne jemi ende duke mësuar rreth virusit të COVID-19 dhe rreth kësaj analize.

Çfarë duhet të bëj nëse kam rezultat pozitiv të analizës?

Duhet të qëndroni në shtëpi për së paku dhjetë ditë, ku së paku tri ditët e fundit të jeni pa ethe (ndërsa nuk merrni mjekime që ulin ethet, si p.sh. acetaminofen apo ibuprofen) dhe me simptoma në përmirësim. Nëse simptomat përkeqësohen apo paraqisni vështirësi në frymëmarrje, telefonojini nr. 911. Nuk ka nevojë ta përsërisni analizën në rast se simptomat ju përmirësohen apo largohen, pasi analiza mund të vijojë të jetë pozitive edhe pas kohës kur ishit ende të infektuar.

Nëse dikush në shtëpinë tuaj ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë me ju, ata duhet të monitorojnë temperaturën dhe të shohin për simptoma, si p.sh. ethe, kollë apo dhimbje fyti për 14 ditë. Ata duhet të shmangin hapësirat dhe transportin publik dhe të mos bien në kontakt me persona të moshuar apo që kanë probleme mjekësore kronike, apo që kanë sistem të dobësuar imunitar.

Çfarë duhet të bëj nëse kam rezultat negativ të analizës?

Nëse nuk keni simptoma, nuk ka nevojë të hyni në izolim shtëpie. Vijoni të merrni masa të rregullta kujdesi, si p.sh. larjen e duarve rregullisht dhe mbajtjen e maskës kur lëvizni në ambiente të jashtme.

Nëse keni simptoma edhe kur keni rezultat negativ të analizës, duhet të qëndroni në shtëpi për së paku dhjetë ditë, ku së paku tri ditët e fundit të jenë pa ethe (ndërsa nuk merrni mjekime që ulin ethet, si p.sh. acetaminofen apo ibuprofen) dhe me simptoma në përmirësim. Nëse simptomat përkeqësohen apo paraqisni vështirësi në frymëmarrje, telefonojini nr. 911. Nëse dikush në shtëpinë tuaj ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë me ju, ata duhet të monitorojnë temperaturën dhe të shohin për simptoma, si p.sh. ethe, kollë apo dhimbje fyti për 14 ditë. Ata duhet të shmangin hapësirat dhe transportin publik dhe të mos bien në kontakt me persona të moshuar apo që kanë probleme mjekësore kronike, apo që kanë sistem të dobësuar imunitar.

Nëse keni pyetje të tjera, kontaktoni me mjekun tuaj të rregullt. Nëse nuk keni një mjek të rregullt, mund t'i telefononi qendrës telefonike të NYC Health + Hospitals në nr. 1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692).

Rrini mirë. Rrini të sigurt.

NYC Health + Hospitals Office of Ambulatory Care (Zyra e kujdesit ambulator të NYC Health + Hospitals)